



# Ndihma Dhe Mbështetje në shtëpi

## Kujt duhet ti drejtohem nëse kemi nevojë për ndihmë në punët shtëpiake ose për përkujdesje në shtëpi?

Persona të kualifikuar në këtë profesion i mbështesin dhe përkujdesen për pacientët e të gjitha moshave të cilët kanë nevojë për kujdes dhe mbikqyrje në shtëpi. Spitexi i ndihmon familjarëve që përkujdesen për të afërmit e tyre në nevojë.

## Çka bën spitexi?

Për në Spitexi bëj kërkesë përsonat që kanë sëmundje trupore dhe mendore, pleqët që kanë nevojë për kujdes, të aksidentuar, nënat pas lindjes dhe në rast të komplikimeve gjatë shtatëzanisë.

Shërbimet e Spitexit përfshijnë:

## Ndihma dhe mbështetje në shtëpinë tuaj:

- Sqarime dhe këshilla për kujdesin mjekësor
- Këshilla për ofertat mjekësore
- Ndihmë në mirëmbajtjen e trupit
- Ndihmë gjatë lëvizjeve në shtratë (mobilizim)
- Përgaditja dhe administrimi i medikamenteve
- Vizita mjekësore siç janë, sëmundja e sheqerit (diabeti) dhe shtypja e gjakut si dhe të tjera
- Trajtimi dhe parandalimi i dhimbjeve
- Shërimi dhe pastrimi i plagëve
- Përcjellja e të vdekurve (kujdesi paliativ)
- Shërbimet e kujdesit psikiatrik
- Kujdesi për fëmijët

## Ndihmë në punët shtëpiake:

- Mbështetje gjatë pazarit
- Pastrimi i shtëpisë
- Larja e rrobave
- Gatimi

## Sipas Rajonit Spitexi orfon dhe:

- Shujta të ushqimeve (shërbimi i ushqimit)
- Vozitje dhe shoqërim tek mjeku ose për blerje
- Dhënje me qera e objekteve ndihmëse (paterica, aparate për inhalim dhe karrocë për invalidë)

## Çka paguan sigurimi shëndetësor?

Sigurimi i detyrueshëm shëndetësor paguan shërbime mjekësore, mirëpo për këtë nevojitet një koordinim ose mirëkuptim në mes të Spitexi-it dhe mjekut.

## Çka nuk paguan sigurimi shëndetësor?

Ndihma në punët e shtëpisë nuk paguhet nga sigurimi bazë i sigurimit shëndetësor. Për këto arsye në shumë sigurime shëndetësore mund ta zgjidhni një sigurim shtesë mbrenda sigurimit bazë. Për më shumë informacione kontaktoni sigurimin shëndetësor. Nëse ju përfiton ndihma nga shteti dhe nuk keni mundësi për pagimin e shërbimeve, atëherë një pjesë të pagesës e paguan bashkia (komuna).

## Çka duhet të paguaj klienti?

- Shuma vjetore e sigurimit shëndetësor
- 10% e shpenzimeve të shërbimeve mjekësore (pagesa vetanake e sigurimit shëndetësor)
- Pjesëmarrje e pacientit në pagimin e shërbimeve mjekësore (shuma mbi 15.35 CHF në ditë sipas kantonit)
- Shpenzimet gjatë ndihmës në punët e shtëpisë

## Me mbështetjen profesionale dhe financiare të migesplus

Schweizerisches Rotes Kreuz  
migesplus.ch



www.migesplus.ch  
Informacione shëndetësore  
në shumë gjuhë

Spitexi ndodhet në çdo rajon të Zvicrrës:

www.spitex.ch → Spitexi në zonën tuaj | Telefon 0842 80 40 20 | Administrata komunale në vendëbanimin tuaj